




Republika e Kosovës

Republika Kosova

Republic of Kosovo



Komuna Skenderaj

Opština Skenderaj

Municipality of Skenderaj

Procesverbal i takimit të dytë publik, të vitit 2025, i mbajtur nga Kryetari i Komunës Sami Lushtaku

Data: 23.12.2025

Ora: 14:00

Vendi: Salla e Kuvendit Komunal, kati IV

Të pranishëm: Kryetari i Komunës, z.Sami Lushtaku dhe qytetarë të pranishëm sipas listës së nënshkrimeve

Kryetari: Përshëndetje të gjithëve, faleminderit që keni ardhur në këtë takim publik, i dyti i këtij viti dhe i pari me mua si Kryetar Komune.

Para jush keni listën me projekte të përfunduara dhe ato të cilat janë në vazhdim, sipas emrit të projekteve si më poshtë:

- Hartimi i projekteve teknike - (vazhdim)
- Punimi i rrjetit të ujësjellësit dhe kyqeve në Burojë - (vazhdim)
- Punimi i kanalizimit në BL Klinë e Epërme, Prekaz, Turiqec, Polac, Qirez, Runik, Likovc dhe Rezallë (vazhdim).
- Trotualet dhe ndriqimi në BL Likovc, Klinë e Epërme, Polac, Runik, Turiqec - (vazhdim)
- Unaza e brendshme 3 krahë kah Llausha - (vazhdim)
- Kanalizimi Syriganë, Banjë – Pemishtë - (vazhdim)
- Asfaltimi i rrugës në Lagjen 3 – Prekaz - (ka përfunduar)

- Punimi i rrjetit të ujësjellësit në BL Qirez - (vazhdim)
- Ndërtimi i Rrugës Kozhicë-Qyqavicë - (ka përfunduar)
- Ndërtimi i Rrugës Syriganë-Bjeshka e Syriganës - (ka përfunduar)
- Rregullimi i subqendrës –Likovc - (vazhdim)
- Rregullimi i subqendrës –Runik - (vazhdim)
- Rregullimi i subqendrës –Qirez - (vazhdim)
- Tribunat në stadiumin e qytetit - (vazhdim)
- Kanalizimi Klinë-Kuqicë - (vazhdim)
- Kanalizimi Aqarevë dhe Kopiliq i ulët dhe në Bl, Runik, Prekaz, Turigec, Qirez, Rezallë, Klinë e Epërme, Polac dhe qytet - (vazhdim)
- Asfaltimi i rrugëve në fshatrat Kuqicë, Qubrel, Kosterc, Vitak, Klladernicë, Burojë, Vajnik, Abri, Ticë, Klinë, Prekaz, Mikushnicë, Polac, Makermal, Rakinicë, Llaushë - (vazhdim)
- Ndërtimi i urave në fshatrat Aqarevë, Llaushë, Kuqicë, Ternavc, Tushilë, Kllodenicë - (vazhdim)
- Asfaltimi i rrugës nga lagja Zabeli deri të shkolla Malush Ahmeti si dhe rrugët lidhëse faza 2 -Rezallë e re - (vazhdim)
- Poligoni sportiv të shkolla Ahmet Delia - (vazhdim)
- Ndërtimi i qerdhës për fëmijë-vazhdimi i aneksit dytë - (vazhdim)
- Kanalizimi fekal Izbicë - Rakinicë dhe Leqinë - (vazhdim)
- Asfaltimi, riparimi dhe kubëzimi i rrugëve në qytet dhe BL Likovc, Turigec, Runik, Qirez - (vazhdim)
- Asfaltimi i rrugëve në fshatrat Klinë, Polac, Makermal, Ticë, Kopiliq i Epërm, Rakinicë - (vazhdim)
- Ndërtimi i muzeut dhe bibliotekës së qytetit - (vazhdim)
- Rregullimi i shtratit të lumit Klinë e ulët-Kuqicë dhe dy degëzimet e Llaushës- (vazhdim)
- Ndërtimi i shetitorës natyrore dhe krijimi i hapësirave rekreative përgjatë shtratit të lumit Klina - (vazhdim)
- Riparimi dhe rregullimi i parkut "Idriz Rreci" dhe "Shaban Polluzha" - (vazhdim)
- Riparimi dhe asfaltimi i rrugëve në qytet - (vazhdim)
- Rregullimi i subqendrës - Klinë e Epërme - (vazhdim)

- Kyqja e kanalizimit lagja Kodra-Polac - (vazhdim)

Kryetari: Jemi të hapur për pyetje, këshilla dhe kritika.

Fjalën po ua kaloj juve.

Xhevat Hoxhaj: Fjala përshëndetëse. Kryetar, kërkesa e parë është një rrethrotullim të xhamia, për shkak se mosfunksionimi i semaforëve po shkakton telashe në rrugë. Gjithashtu, kërkesë tjetër është ndriqimi në lagjen 3, pastrimi i rrugëve nga therrat në fshatra dhe ujësjellësi të funksionalizohet.

Kryetari: Faleminderit. Ndriqimi, është në proces dhe do të përfundohet në gjithë Komunën. Rrethrotullimi do të bëhet ose me mundësi nënkalimi. Pastrimi i rrugëve do të vazhdojë dhe do të përfundohet.

Avdullah Qorri: Fjala përshëndetëse. Kryetar, kanalizimi në Ticë nuk ka përfunduar, gjithashtu dhe asfaltimi i rrugëve nuk ka përfunduar, ka shumë lagje në të cilat rrugët janë të paasfaltuara. Kryetar edhe ujësjellësi është i shtrirë por nuk ka ujë, problem këtu është edhe uji i pusëve, i cili është i papijshëm, që banorët detyrohen ta përdorin.

Kryetari: Asfaltimi i rrugëve do të përfundoj, por njëherë nuk mundemi për shkak të kohës, sepse me thënë të drejtën, nuk kam dëshirë që sot të asfaltohet rruga e pas 3 ditësh të dëmtohet.

Problemi i ujit është edhe në qytet, zgjidhja e këtij problemi është projekti i Pendës së Kuqices, do të bëjmë presion institucional që ky projekt të implementohet. Penda e Kuqicës nuk varet nga Komuna. Kanalizimi do të përfundoj brenda mandatit, do të mbajm takime në secilin fshat për t'i parë nga afër problematikat që i kanë banorët.

Kushtrim Dragaj: Fjala përshëndetëse. Kanalizimi Izbicë, Rakinicë dhe Leqinë, nuk ka filluar edhe pse figuron në listë të projekteve.

Kryetari: Ne do të fillojmë nga qyteti t'i zgjidhim problemet me kanalizimin dhe pastaj do të vazhdojmë me fshatra.

Liridona Koci: Fjalimi hyrës. Kryetar, rruga për Vushtrri, ka aksidente për shkak të prishjes së asfaltit.

Kryetari: Kam kalu në atë rrugë, e di për këtë problem, do të dalim bashkë me Drejtorinë e Urbanizmit për të shiku qa mundemi të bëjmë.

Xhevat Hoxhaj: Kryetar, propozoj që pagesat e mbeturinave, të bëhet e detyrueshme në tatim, problem tjetër janë qent endacak.

Kryetari:Faleminderit. Një organizatë amerikane është e interesuar që të ndërtoj një strehimore për të grumbulluar dhe sterilizuar qent. E dijmë që është një problem i madh jo vetëm në Komunën tonë por në të gjitha komunat.

Kryetari: A ka ndonjë pyetje tjetër? Nëse jo, faleminderit shumë për pjesëmarrjen në këtë takim, shpresoj që takimet e tjera të jenë më të mëdha, sepse kur po takohemi në kafe, qytet, ankesat po janë të shumta, mirëpo pjesëmarrja në takime publike nuk është e kënaqshme.

Faleminderit. Këtu e mbylli këtë takim. Iu uroj ditë të mbarë.



Procesmbajtës, Besjana Thaçi